

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Antisol® E

NDIHMUES I MPIKSJES SË BETONIT

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Antisol® E është ndihmues i mpiksjes së betonit i lëngshëm që aplikohet me spërkatje për parandalimin e humbjes së ujit nga sipërfaqja e betonit të freskët të derdhur. Formon një shtresë të hollë barriere mbi betonin pa ndikuar në veprimin normal të mpiksjes.

PËRDORIMET

Zona të mëdha prej betoni të ekspozuar si:

- Rrugë dhe autostrada
- Rrugëkalime
- Çati dhe tarraca
- Hangarë dhe zona ngarkimi
- Mure mbajtës
- Struktura të paranderura
- Kanale kulluese
- Struktura të inxhinierisë së ndërtimit
- Dysheme industriale

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përmirëson në përgjithësi paraqitjen e sipërfaqes
- Redukton plasaritjen
- Siguron arritjen e rezistencave të kërkuara
- Redukton tkurrjen
- Kontrollon hidratimin e çimentos
- Redukton formimin e pluhurit
- Përmirëson rezistencën ndaj ngrirjes-shkrirjes
- Lehtëson metodat e tjera të kushtueshme të trajtimit

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Fuçi 25 dhe 200 kg.
Paraqitja / Ngjyra	Emulsion i lëngët me pigment të bardhë
Jetëgjatësia	6 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Referohuni gjithmonë tek ambalazhi.
Dendësia	~0,98 ± 0,05 kg/l

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	0,15–0,20 kg/m ² Konsumimi varet nga shpejtësia e erës, temperatura dhe lagështia gjatë aplikimit. Këto vlera janë teorike dhe nuk përllogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.
Pajisjet	Aplikimi <ul style="list-style-type: none">Me pompë manuale shpine ose spërkatës të motorizuarPërshtatshmëria e pajisjes duhet të miratohet përpara se të përdoret për aplikimin e plotë Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Sipërfaqja e betonit nuk duhet të ketë ujë të ndenjtur. Avullimi i ujit mbi sipërfaqe mund të zgjasë nga 30 min. deri në 2 orë, në varësi të temperaturës dhe raportit ujë/ çimento.

APLIKIMI

Përzieri plotësisht përpara përdorimit për të siguruar shpërndarjen e plotë të solideve. Spërkasni produktin për të mbuluar plotësisht sipërfaqen e betonit. Ruani presionin në pajisjen e aplikimit për të siguruar një spërkatje të njëtrajtshme.

KUFIZIME

- Për të parandaluar bllokimin e grykëdaljes, pastroni rregullisht pajisjen e spërkatjes gjatë aplikimit.
- Pas aplikimit, duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 2-3 orë, në varësi të kushteve të ambientit.
- Sika® Antisol® E duhet të hiqet përpara aplikimit të ndonjë veshjeje ose shtresë tjetër.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Antisol® E

Shkurt 2019, Botimi 02.01

021405031000000007

SikaAntisolE-sq-AL-(02-2019)-2-1.pdf

